

## 4. Ka edhe tabu

*«Askush nga ata nuk do të ulej e as do të fuste gjë në gojë... Ndërsa u shprehja habinë time për këtë, më thanë se këto veprime ishin tabu. Kjo fjalë kishte një kuptim të thellë e disi të koklavitur; në përgjithësi donte të thoshte se diçka ose një veprim ishte i ndaluar...»*

*Kapiten Xhejms Kuk [1777]\**

Me tabu përgjithësisht kuptohet ndalimi shoqëror kundër fjalëve, objekteve dhe veprimeve që konsiderohen si të padëshirueshme nga një grup, kulturë ose shoqëri. Vetë termi që, me sa duket, vjen prej gjuhëve polineziane të Paqësorit Jugor, ku shënon ‘diçka të ndaluar’<sup>1</sup>, duke ruajtur pak a shumë po atë domethënie hyri në fillim në anglisht e mandej u përhap edhe në gjuhë të tjera. Lindja dhe përhapja e tabuve shpesh është kundruar si e lidhur ngushtë me shfaqjen e feve politeiste.

Psikologu gjerman Vilhelm Vundt mendonte se «në krye të herës tabutë nuk ishin gjë tjetër përpos sendësimit të frikës ndaj fuqisë së xhindeve, për të cilat besohej se fshiheshin pas objekteve të shndërruara në tabu»<sup>2</sup>.

\* Cituar sipas *Enciklopedisë britanike*.

<sup>1</sup> Po aty.

<sup>2</sup> Sigmund Freud, *Totem and Taboo: Some Points of Agreement between the Mental Lives of Savages and Neurotics*, përkthimi i Strachey-t, W. W. Norton & Company, New York, 1950, f. 24.

Frojdi nuk e pranon këtë shpjegim duke dhënë si provë të cektësisë së tij ngjashmëritë mes atyre që i respektonin tabutë dhe neurotikëve obsesivë. Qoftë të parët, qoftë të dytët i shohin disa sende ose njerëz si të paprekshëm. Të tillë janë prijësit për aborigjenët dhe babai ose psikanalisti për neurotikët. Sipas Frojdit, tabuja është pasojë e standardit të dyfishtë në shoqëri dhe, po ashtu, shfaqje e ndalimit të atyre veprimeve për të cilat njeriu ndien shtysa të fuqishme në nënvetëdijen e tij<sup>3</sup>. Frojdi pohon gjithashtu se dy janë tabutë universale: incesti (gjaktrazimi) dhe patricidi (atëvrasja), të cilat formojnë edhe bazat e shoqërisë moderne<sup>4</sup>. Është e vërtetë se tabuja e incestit lidhet më fort me botëkuptimin dhe mendësinë perëndimore, ku farefisnia nënkupton lidhjet e gjakut, ndërsa në tributë aborigjene farefisnia konceptohet mbi bazën e lidhjeve totemike. Por edhe ky fakt nuk e vë në pikëpyetje universalitetin e tabusë në lidhje me incestin, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me ndryshime tipologjike dhe jo topologjike, sepse, tek e fundit, ndalesa mbetet e njëjtë në të dyja kulturat.

Të tjerë studiues, si Marvin Harris, janë përpjekur t'i shpjegojnë tabutë me kushtet socio-ekonomike të një bashkësie të dhënë në një kohë të caktuar. Tashmë ka fituar terren teza, sipas së cilës, tabutë janë më të hershme edhe se vetë zotat dhe datojnë në një periudhë kur nuk ekzistonte asnjë fe.

Në shoqëritë e ashtuquajtura komplekse, me të cilat kuptohen rëndom shoqëritë e zhvilluara industriale të botës perëndimore, mund të vëresh dy lloj tabush. Ka veprime që ndalohen rreptësisht me anë të ligjit; shkelja e tyre mund të sjellë ndëshkime të rënda. Për këtë arsye tabutë mbahen edhe si një element rregullator i rendit në një shoqëri. Nga ana tjetër, ekzistojnë tabu, mosrespektimi i të cilave shkakton

<sup>3</sup> Po aty, f. 26-30.

<sup>4</sup> Po aty.

përçmimin, diskreditimin, madje edhe lëçitjen nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Pavarësisht prej dallimeve në kohë dhe në kultura të ndryshme, tabutë i bashkojnë dy elemente thelbësore. I pari ka të bëjë me idenë e ndalimit që i imponohet dikujt nga dikush tjetër, gjë që të shpie pandërmjetshëm te përpjekjet për vendosjen e kontrollit shoqëror, ndërsa i dyti ka të bëjë me standardin e dyfishtë në një shoqëri, çka e shqetësonte edhe Frojdin, e që tek e mbramja zbulon edhe amoralitetin e një shoqërie (kupto të grupit shoqëror dominant) që shtiret se lufton imoralitetin. Lidhur me standardin e dyfishtë që latinët e perifrajuan me *Qvam licent Jovi, non licent bovi*, më duket me vend të kujtoj disa vargje të Omar Khajamit në përkthimin e Nolit: *Të madhit Muhamet i çon selam/ dhe e pyet imami Omar Khajam/ O Pejgamber, më thuaj mor aman/ pse dhallën bën hallall e verën bën harram/ Përgjigjet Muhameti me selam/ s'më more vesh imam Omar Khajam/ dhallën hallall për lolot mor aman/ verën për të urtët nuk e bëj harram*<sup>5</sup>.

Tabutë i interesojnë edhe gjuhëtarit në masën që ato pasqyrohen si ndalim gjuhësor. Nensi Haston në studimin e saj mbi fjalët e ndyra dhe ato trashamane vëren se «...për shkak të censurës shoqërore gjithnjë në rritje, edhe prodhuesit e fjalëve që cenonjë ‘moralin në të folur’, shtrëngohen të shtien në punë ‘paqtuesin e madh’, eufemizmin»<sup>6</sup>. Eufemizmat (termi vjen nga greqishtja ku ka kuptimin ‘bukurtingëllim’), janë metafora ose shprehje të tjera të figurshme që thirren në ndihmë për të zëvendësuar tabutë. Në këtë kuptim eufemizmi përbën një shformim të raportit shenjues – i shenjuar. Edhe pse njëri nga funksionet e ligjërimit studentor është ai *çlirues*, që pos të tjerave parakupton edhe flakjen tej të tabuve, eufemizmat nuk mund t’i mungojnë

<sup>5</sup> Fan Noli, *Vepra I*, ASHRSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1987.

<sup>6</sup> Nancy Huston, *Dire et interdire, éléments de jurologie*, Payot, Paris 1980, f. 65.

as këtij entiteti. Norma sociolinguistike, e kuptuar si tërësia e sjelljeve gjuhësore të pritshme nga ana e anëtarëve të një bashkësie në një situatë të dhënë komunikimi<sup>7</sup>, u imponon edhe studentëve disa ndalime, të cilave nuk mund t'u shmangen. Këto lloj ndalimesh bëhen më të prekshme kur ata janë të detyruar të komunikojnë me të tjerë njerëz që nuk bëjnë pjesë në grupin e tyre.

Për ta ilustruar këtë ide po jap vetëm një shembull. Norma sociolinguistike në shqipe ia ndalon një të riu t'i drejtohet me emër një të moshuari. Varësisht prej të ashtuquajturit relacioni i rolit<sup>8</sup>, zgjedhjet e mundshme janë *xhaxhi X* ose *zoti X*.

Në rast të kundërt ndëshkimi shoqëror *pse petullat i ke ngrënë ti këtij*<sup>9</sup>, është i menjëhershëm.

Për t'i bishtnuar këtij rregulli të rinjtë në përgjithësi përdorin shpesh fjalët *usta* ose *mjeshtër* me vlerën e një apelativi më neutral në terma të autoritetit. E meqë jemi te raportet ndërpersonale ia vlen të kujtoj se norma sociolinguistike në shqipe dikur impononte edhe ndalime të tjera të ngjashme.

Prof. Shkurtaj thotë se «në traditën e vjetër shqiptare ka qenë e ndaluar që gruaja dhe burri t'i thërrasin njëri-tjetrit me emër. Siç e ka shprehur poetikisht Ali Asllani "... pasi femra kurrë s'mund t'i flasë me emër burrit që ka burrë". Prandaj, sipas krahinave, por gati kudo në të njëjtën mënyrë, emri i bashkëshortit jepej me fjalëza zëvendësuese, ku zotërojnë përemrat *ky, kjo, ai, ajo*, apo togfjalësha që nisin me to, si: *ai njeri, ai burri, ai trimi, ajo gruaja* [...] Gati gjithandej në trevat shqiptare për të mos përmendur emrin e bashkëshortit, burri e thërriste gruan

<sup>7</sup> Shih Gaetano Berruto e Monica Berreta, *Lezioni di sociolinguistica e di linguistica applicata*, Liguori Editore, Napoli, 1977.

<sup>8</sup> Shih Joshua Fishman, *La sociologia del linguaggio*, Officina Edizione, Roma, 1975.

<sup>9</sup> Tradita shqiptare e do që miqtë e ardhur për të uruar lindjen e një fëmije të gostiten së pari me petulla.

me emrin e njëres prej vajzave, kurse gruaja në emrin e njërit prej djemve»<sup>10</sup>.

Afërmendsh që pjesa më e madhe e eufemizmave në ligjërimin studentor ka të bëjë me aspekte të caktuara të seksualitetit, e në këtë kuptim ato lidhen më fort me të ashtuquajturat ‘fjalë të ndyra’. Nensi Haston përpiket të bëjë dallimin mes ‘fjalës së ndyrë’ dhe ‘fjalës trashamane’: «...e para *shënon* një objekt të ndaluar; e dyta *është* një objekt – një fjalë e ndaluar. Mut është një fjalë e ndyrë kur shënon jash-tëqitjen dhe një fjalë trashamane kur një gur bie mbi kokën tonë»<sup>11</sup>. Ky dallim na ndihmon të shohim më qartë atë që njihet si desemantizim i fjalës, përmes të cilit ajo kalon nga një stad në një tjetër, duke pushuar së qeni një *fjalë e ndyrë* për t’u kthyer në një *fjalë trashamane*. E po ashtu ai nxjerr në spikamë edhe se sa të rëndësishme mund të jenë rrethanat në të cilat realizohen thëniet. E njëjta autore shton se «janë të shumta procedetë e përdorura për të shmangur ‘fjalët e ndyra’. Ato shkojnë nga manipulimet tipografike (në të shkruar) deri te procedetë semantike, si metaforat»<sup>12</sup>. Gjithashtu, Hastoni bën fjalë edhe për procede morfologjike e fonetike.

Ndër mjetet që përdorin bartësit e ligjërimin të sotëm studentor për prodhimin e eufemizmave do të veçoja së pari metaforat, të cilat i gjen në njësitë *i kanë ardhur bojaxhinjtë, i ka ardhur tezja nga Vithkuqi*, që të dyja me kuptimin ‘menstruacionet’, *është i shoqatës, është i fushës* me kuptimin ‘homoseksual’ etj. Tek e para shoqërimi i ideve me ngjyrat dhe me çrregullimin duket sikur e zbeh ca lidhjen me referentin; ndërsa tek e dyta gjetja është më banale, sepse, sipas meje, mbështetet mbi një lojë fjalësh me ‘vithet e kuqe’, që në këtë rast shërben edhe si etimologji popullore për toponimin Vithkuq.

<sup>10</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 266.

<sup>11</sup> Nancy Huston, *Dire et interdire...*, vep. e cit., Payot, Paris, 1980, f. 40-41.

<sup>12</sup> Po aty.

Përveç metaforave në rolin e eufemizmave dalin edhe trajtat e apokopuara të fjalëve, si për shembull *debi, psiko, homo* etj., të cilat ua zbusin sado pak gjegjëseve të tyre ngjyrimin përkeqësues.

Funksion eufemistik ka sipas meje dhe trajta e shumësit për emrin në njësinë *vari karat, vari lesht*, por lidhja e fortë me referentin i kthen në rastin më të mirë në pseudoeufemizma, kategori për të cilën bën fjalë edhe prof. Shkurtaç<sup>13</sup>. Të tilla (pseudoeufemizma) janë edhe njësitë *hajdar, toç kuklle* e ndonjë tjetër.

Në ligjërimin e sotëm studentor hasen me vlerën e eufemizmave edhe disa huazime, si *kaco, un tubo, merda, shit, fuck* etj. Po ashtu, nuk mungojnë edhe rastet kur këtë detyrë e kryejnë huazimet më të reja përballë të vjetrave, për shembull *gay* për *homoseksual, kondom* për *prezervativ* etj.

Njësitë *bar, i bërë, mall e mallist*, që të gjitha të lidhura me botën e drogës, më shumë se me një përpjekje të vetëdijshme për të ‘sajuar’ eufemizma kanë të bëjnë me një rrekje për t’iu shmangur gjegjëseve të tyre të mëparshme, tejet të konsumuara. Megjithatë ato mund të njehen si të tilla përballë njësive *drogaxhi, drogmen, hashash* dhe *droguar*. Vdekja nuk i shqetëson të rinjtë, prandaj mund të thuhet se ajo nuk e meriton vëmendjen e tyre.

<sup>13</sup> Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 266.